



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

DOKUMENT I SHKURTËR I POLITIKAVE

SHQYRTIMI I PËRGJIGJES SË NATO-S

Cili është partneriteti me Kosovën?

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Plator Avdiu

Redaktimi i brendshëm: Florian Qehaja

Janar 2017

Prishtinë

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat për pronësi intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe Ligjin Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen paraprake të botuesit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e partnerëve apo donatorëve të saj.

Përmbajtja

Gjetjet kryesore.....	4
Hyrje.....	5
1. Perspektiva e marrëdhënieve Kosovë-NATO	5
2. Shqyrtimi i programeve të partneritetit të NATO-s	7
2.1. Programet për mbrojtje nga sulmet kibernetike, edukim, trajnim dhe logjistikë	8
2.2. Programi për Ndërtimin e Integritetit	9
2.3. Programi Shkenca për Paqe dhe Siguri	10
2.4. Qendra Koordinuese Euro-Atlantike për Reagim ndaj Fatkeqësive	11
2.5. Diplomacia Publike	12

Gjetjet kryesore

- Marrëdhëniet e reja ndërmjet Kosovës dhe NATO-s pritet të nisin në vitin 2017. Kjo ishte paralajmëruar në letrën me dykuptimësi të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dërguar kryeministrit të Kosovës në dhjetor të vitit 2016. Megjithatë, përgjigja e NATO-s për Qeverinë e Kosovës është një hap shumë i vogël sa i përket bashkëpunimit të ardhshëm në mes të Kosovës dhe NATO-s. Prandaj, ajo është larg nga të qenit çfarë ka kërkuar Kosova dhe për më tepër nuk është në përputhje me diskursin politik të zyrtarëve të institucioneve të Kosovës që e paraqitën atë si një hap të madh.
- Përgjigja e NATO-s hap zyrtarisht rrugën për Kosovën që të marr pjesë në disa prej programeve të NATO-s duke balancuar mandatin ekzistues të pranisë së KFOR-it/NATO-s në Kosovë përmes "ndërveprimit". Në këtë drejtim, NATO-ja ka përcaktuar kornizën e bashkëpunimit duke i mundësuar Kosovës të përfshihet në programet e caktuara të NATO-s për institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore të Kosovës. Që këtë, për herë të parë Kosova do të marrë pjesë në programet dhe instrumentet e NATO-s.
- Në kuadër të marrëdhënieve të reja Kosovë-NATO do të ketë komunikim të shpeshtë dhe vizita të rregullta të zyrtarëve të lartë të NATO-s në Kosovë. Për më tepër, Kosova fillimisht do të marrë pjesë në këto programe të NATO-s, siç janë Programi për Ndërtimin e Integritetit, Programi Shkenca për Paqe dhe Siguri të NATO-s, programi i Diplomacisë Publike si dhe do të parashihet pjesëmarrja e mundshme e Forcës së Sigurisë së Kosovës si vëzhguese në ushtrimet e Qendrës Koordinuese Euro-Atlantike për Reagim ndaj Fatkeqësive.
- Edhe pse paraqet hapin e parë drejt një bashkëpunimi fillestar të Kosovës me NATO-n, prapëseprapë ky "ndërveprim" nuk nënkupton që Kosova është vend partner i NATO-s nëse kjo krahasohet me vendet tjera të rajonit. Kjo për shkak të qasjes neutrale të NATO-s kundrejt shtetësisë së Kosovës duke e ditur që katër vende anëtare të NATO-s (Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja) nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës.

Hyrje

Përgjigja e NATO-s drejtuar Qeverisë së Kosovës dëshmon se është arritur një hap shumë i vogël lidhur me bashkëpunimin e ardhshëm ndërmjet Kosovës dhe NATO-s. Si e tillë, ajo është larg se çfarë Kosova meriton dhe në të njëjtën kohë nuk është në përputhje me deklaratimet e zyrtarëve të institucioneve të Kosovës që e paraqitën atë si një hap të madh. Kosova me automatizëm i plotëson kushtet profesionale dhe politike për të hyrë në programin Partneriteti për Paqe, ndonëse sfidat politike si pasojë e mosnjohjes së Kosovës nga katër vende anëtare të NATO-s do të vazhdojnë të dobësojnë pozitën e ardhshme të Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare.

Në vitin 2017 NATO-ja do të fillojë disa forma të bashkëpunimit me Kosovën. Kjo ishte paralajmëruar në letrën me dykuptimësi të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s drejtuar kryeministrit të Kosovës në dhjetor të vitit 2016. Në letër thuhet se zyrtarisht do të fillojë pjesëmarrja e Kosovës në disa prej programeve të NATO-s duke balancuar mandatin ekzistues të pranisë së KFOR-it/NATO-s me nevojën për pjesëmarrje graduale të Kosovës në programet e NATO-s. Me fjalë të tjera, NATO ka përcaktuar tashmë kornizën e bashkëpunimit duke mundësuar përfshirjen e Kosovës në programe të caktuara të Aleancës së NATO-s për institucionet shtetërore dhe jo-shtetërore të Kosovës duke shënuar kështu për herë të parë pjesëmarrjen e Kosovës në programet dhe instrumentet e NATO-s.

Ky raport ka për qëllim të zbërthejë kërkesat e Qeverisë së Kosovës drejtuar nivelit më të lartë politik të NATO-s dhe përgjigjen nga NATO-ja. Sidoqoftë, sfidat vazhdojnë të mbesin për shkak të refuzimit të katër vendeve anëtare të NATO-s të njohin shtetësinë e Kosovës dhe për shkak të qëndrimit neutral të NATO-s kundrejt shtetit të Kosovës. Me synimin për të kuptuar më mirë programet e NATO-s që i janë ofruar Kosovës, raporti analizon secilin prej programeve në mënyrë që audienca të kuptojë plotësisht bashkëpunimin e ardhshëm Kosovë-NATO.

1. Perspektiva e marrëdhënieve Kosovë-NATO

Angazhimi praktik i Kosovës në procesin e anëtarësimit në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) ka shënuar një pikë kthesë kur institucionet e Kosovës kërkuar zyrtarisht nga strukturat më të larta politike të NATO-s vendosjen e bashkëpunimit dhe partneritetit zyrtar. Në nëntor të vitit 2015, kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, i dërgoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg për vendosjen e marrëdhënieve politike ndërmjet Kosovës dhe NATO-s. Me qëllim të nisjes së marrëdhënieve reciproke zyrtar ndërmjet të dyja palëve, Qeveria e Kosovës ka vënë theksin në këto çështje kryesore: (i) dialog politik Kosovë-NATO në baza të rregullta në nivelin më të lartë politik dhe ministror; (ii) themelimin e zyrës ndërlidhëse të Kosovës në selinë e NATO-s në Bruksel; (iii) asistencën, vlerësimin dhe zhvillimin e programit individual të bashkëpunimit për fuqizimin e bashkëpunimit me NATO-n; (iv) ngritjen e nivelit të pranisë civile dhe ushtarake të NATO-s në Kosovë, veçanërisht shkrirjen e Ekipit Ndërlidhës dhe Këshillues të NATO-s dhe Ekipit Këshillues të NATO-s në një ekip të vetëm të NATO-s në Kosovë; (v) Grante të Bashkësponsorizuara të Divizionit për Diplomaci Publike të NATO-s për institucionet e Kosovës, organizatat joqeveritare, universitetet, institutet hulumtuese dhe organizatat tjera të shoqërisë civile për çështje të paqes dhe sigurisë; (vi) qasjen e Kosovës në programet dhe instrumentet e NATO-s, përfshirë Programin Shkenca për Paqe dhe Siguri dhe Programin për Ndërtimin e Integritetit që mund të fuqizojnë bashkëpunimin dhe dialogun e Kosovës me NATO-n dhe partnerët e saj.¹

Duke e marrë parasysh qëndrimin neutral të NATO-s ndaj statusit të Kosovës, ajo i është përgjigjur në mënyrë të kujdesshme institucioneve të Kosovës në lidhje me bashkëpunimin e mundshëm të kësaj të fundit me NATO-n. Në letrën dërguar kryeministrit të Kosovës në dhjetor të vitit 2016, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s ka konstatuar se Këshilli Veri-Atlantik

1 KIPRED, "The Kosovo Security Sector Observer", Volume I, No. 4, korrik 2016, f. 22. Gjetet në: <https://goo.gl/jNkFI3>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

(NAC) i NATO-s ka gjetur pajtim për një formë të re bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe NATO-s përmes "ndërveprimit" që do të nis në vitin 2017.² Edhe pse paraqet hapin e parë drejt bashkëpunimit fillestar të Kosovës me NATO-n, megjithatë ky ndërveprim nuk nënkupton që Kosova është vend partner i NATO-s nëse krahasohet me vendet partnere të NATO-s. Kjo është për shkak se 4 prej 28 vendeve anëtare të NATO-s nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, përfshirë Greqinë, Sllovakia, Rumaninë dhe Spanjën. Vendet mos-njohëse të NATO-s kanë kundërshtuar në vazhdimësi vendosjen e partneritetit zyrtar dhe dialogut politik të Kosovës me NATO-n me arsyetimin se kjo do të cenonte neutralitetin e NATO-s kundrejt shtetësisë së Kosovës.³ Shkaqet e refuzimit të tyre për të njohur Kosovën mund të gjenden tek problemet e brendshme të këtyre vendeve, ku veçanërisht Spanja vlerësohet se është fuqimisht kundër vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe NATO-s.⁴

Në kontekstin aktual sfidat politike janë shmangur për t'i mundësuar Kosovës të hyjë në një lloj bashkëpunim sadopak minimal pavarësisht porosive me dykuptimësi të NATO-s. Ndërkohë, është me rëndësi të theksohet se vendet anëtare të NATO-s të cilat përkrahin rrugën e Kosovës drejt NATO-s kanë kontribuar në mënyrë të rëndësishme për nisjen e bashkëpunimit Kosovë-NATO. Këto vende vazhdimisht kërkojnë nga strukturat vendimmarrëse të NATO-s të zyrtarizojnë në mënyrë të qartë marrëdhëniet me Kosovën.⁵ Kur analizohet letra e Sekretarit Stoltenberg, ndërveprimi Kosovë-NATO nuk do të zhvillohet drejtpërdrejtë nga selia e NATO-s në Bruksel, por përmes ndërveprimit të institucioneve të Kosovës me misionin paqeruajtës të forcave të NATO-s në Kosovë (KFOR) dhe Ekipit Këshillues dhe

Ndërlidhës të NATO-s (NALT) në Kosovë. Sa i përket KFOR-it, NATO ka përsëritur në Samitin e Varshavës më 2016 se do të vazhdojë të qëndrojë në Kosovë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe se çfarëdo ndryshimi i trupave të KFOR-it do të jetë "i bazuar në kushte dhe jo sipas afateve kalendarike".⁶ NALT-i që u themelua në gusht të vitit 2016 pas shkrirjes së Ekipit Ndërlidhës dhe Këshillues të NATO-s dhe Ekipit Këshillues të NATO-s funksionon në kuadër të Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).⁷ Si i tillë, është një trup këshillues i ndarë nga KFOR-i dhe shërben si lidhje ndërmjet NATO-s dhe MFSK-së. Kur bëhet fjalë për bashkëpunimin me NATO-n, pritet që nga viti 2017 NALT-i të jetë pika kryesore për koordinimin e aktiviteteve të bashkëpunimit praktik ndërmjet Kosovës dhe NATO-s.⁸ Prandaj, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s duke vepruar në bazë të pajtim të NAC-së së NATO-s ka propozuar kornizën e aktiviteteve të ndërveprimit ndërmjet të dyja palëve që parashihet të fillojnë në vitin 2017.

Në kuadër të fuqizimit të këtij ndërveprimi do të ketë komunikim më të shpeshtë dhe vizita të rregullta të NAC-së së NATO-s në misionin e KFOR-it në Kosovë. Në këto vizita do të ketë takime të NAC-së së NATO-s me KFOR-in, NALT-in dhe përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës me qëllim të ngritjes së dialogut politik. Përveç intensifikimit të komunikimit reciprok të Kosovës me NATO-n, pritet të diskutohen fushat e bashkëpunimit praktik të Kosovës me NATO-n në kuadër të mandatit të NAC-së së NATO-s.⁹

Në kontekstin e nisjes së bashkëpunimit me institucionet e Kosovës, NATO-ja do të ofrojë aktivitete

2 Letra e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, drejtuar kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, 5 dhjetor 2016, SG(2016)0357, f. 1.

3 Diskutim me një zyrtar të lartë të NATO-s, 14 nëntor 2016, Bruksel.

4 Diskutim me një përfaqësues të lartë të një vendi anëtar të NATO-s që përkrah anëtarësimin e Kosovës në NATO, 14 nëntor 2016, Bruksel.

5 Top Channel, "NATO dhe Shqipëria, Bushati flet për Kosovën, Trump dhe Rusinë", 6 dhjetor 2016. Gjendet në: <<https://goo.gl/qdxx6w>>. Qasur më 7 dhjetor 2016.

6 Para. 89, Warsaw Summit Communiqué, Press Release (2016) 100, 9 korrik 2016. Përditësimi i fundit më 3 gusht 2016. Gjendet në: <<https://goo.gl/OGUBPS>>. Qasur më 5 dhjetor 2016.

7 Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, "NATO mandaton Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës për Ministrinë e FSK-së dhe FSK-në", 24 gusht 2016. Gjendet në: <<https://goo.gl/5fBfRI>>. Qasur më 12 dhjetor 2016.

8 Letra e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, drejtuar kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, 5 dhjetor 2016, SG(2016)0357, f. 2.

9 Po aty, f. 1.

shtesë për Kosovën për pjesëmarrje në programet përkatëse të partneritetit¹⁰ të NATO-s, ndonëse në fusha të kufizuara të këtyre programeve. Në përputhje me këtë, Kosova mund të përfshihet që të marrë pjesë në programet e NATO-s, përfshirë mbrojtjen nga sulmet kibernetike, edukimin, trajnimin dhe logjistikën. Kosova do të përfshihet në Programin për Ndërtimin e Integritetit për të ngritur aktivitetet e Kosovës me NATO-n me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve institucionale. Përfshirja në mënyrë zyrtare e Kosovës në Programin për Ndërtimin e Integritetit do të fuqizojë përpjekjet ekzistuese të Qeverisë së Norvegjisë në MFSK që ka mbështetur masat e integritetit në nivel ndërshtetëror. Një program tjetër ku do të përfshihet Kosova përmes ndërveprimit është Programi i NATO-s Shkenca për Paqe dhe Siguri për bashkëpunim në fushë të sigurisë në çështjet që ndërlidhen me shkencën, teknologjinë, risinë dhe përtej kësaj. Mirëpo, pjesëmarrja e Kosovës në këtë program nuk është plotësisht e garantuar meqë NATO-ja do të shqyrtojë mundësitë e pjesëmarrjes së Kosovës në kuadër të aktiviteteve të këtij programi.

Lidhur me aktivitetet e FSK-së dhe mundësinë e përfshirjes për të bashkëpunuar me NATO-n, kjo e fundit ka propozuar pjesëmarrjen e FSK-së në rolin e vëzhguesit në Qendrën Koordinuese Euro-Atlantike për Reagim ndaj Fatkeqësive (EADRCC) gjatë Ushtrimeve për Menaxhimin e Pasojave. Rrjedhimisht, FSK-ja mund të bëhet pjesë e ushtrimeve të EADRCC-së në kuadër të mandatit ekzistues të FSK-së. Për më tepër, NATO-ja në bashkërendim me NALT-in do të shqyrtojë mundësitë sa i përket pjesëmarrjes së FSK-në ushtrime të përbashkëta me KFOR-in.

Përveç përfshirjes së institucioneve shtetërore, edhe për aktorët jo-shtetërorë është mundësia të përfshihen në programet dhe instrumentet e NATO-s. Në këtë mënyrë, pritjet që Kosova do të bëhet pjesë e çështjeve të diplomacisë publike përmes Divizionit për Diplomaci Publike të NATO-s për bashkëpunim të mëtejshëm e cila do të mbështes institucionet përkatëse të Kosovës, organizatat joqeveritare, universitetet, institutet hulumtuese dhe organizatat tjera të

shoqërisë civile në çështje të sigurisë, paqes, komunikimit dhe çështjeve të Diplomacisë Publike.¹¹

Mund të thuhet se përkundër sfidave ekzistuese marrëdhëniet e reja të Kosovës me NATO-n përmes bashkëveprimit reciprok shënojnë një hap shumë të rëndësishëm dhe pikë kthesë për rrugën e Kosovës drejt vendosjes së marrëdhënieve zyrtare me NATO-n. Institucionet e Kosovës duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të shëndoshë për të fuqizuar marrëdhëniet me NATO-n në programet e partneritetit të kësaj të fundit.

2. Shqyrtimi i programeve të partneritetit të NATO-s

NATO-ja përbëhet prej 28 vendeve anëtare¹² nga Evropa dhe Amerika Veriore. Kjo organizatë ka zhvilluar në vazhdimësi forma të bashkëpunimit me vendet partnere ose vendet që nuk janë anëtare të NATO-s përmes programeve të ndryshme të partneritetit. Partneritetet e NATO-s janë krijuar dhe zhvilluar me qëllim të fuqizimit të dialogut politik dhe bashkëpunimit praktik në mes të vendeve partnere dhe NATO-s për të kontribuar në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare.¹³

Në parim, korniza e partneritetit të NATO-s me vende partnere përkatëse bazohet në vlerat e përbashkëta, reciprocitet si dhe në përfitim e respekt të dyanshëm. Në këtë drejtim, prej programeve më të njohura të partneritetit të NATO-s me vendet partnere janë Këshilli për Partneritet Veri-Atlantik (EAPC) dhe Partneriteti për Paqe (PfP) në të cilat janë të përfshira

¹⁰ Pjesa e dytë e raportit shpjegon programet e partneritetit të NATO-s.

¹¹ Letra e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, drejtuar kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, 5 dhjetor 2016, SG(2016)0357, f. 2.

¹² Shih vendet anëtare të NATO-s në: <<https://goo.gl/Hvkeu7>>. Përditësimi i fundit më 30 qershor 2016. Qasur më 5 dhjetor 2016.

¹³ Para. 98, Warsaw Summit Communiqué, Press Release (2016) 100, 9 korrik 2016. Përditësimi i fundit më 3 gusht 2016. Gjendet në: <<https://goo.gl/QGUBPS>>. Qasur më 5 dhjetor 2016.

22 vende partnere¹⁴, të cilat kanë marrëdhënie partneriteti me NATO-n dhe 28 shtetet anëtare të saj. Për më tepër, është vendosur bashkëpunim dhe partneritet në struktura të ndryshme me rajone të tjera, përfshirë Dialogu i NATO-s me Mesdheun, Nisma e Stambollit për Bashkëpunim dhe Partnerët përtej globit si dhe ka bashkëpunim të NATO-s me organizatat ndërkombëtare (Kombet e Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë).¹⁵ Partnerët individualë gjatë bashkëpunimit me NATO-n vendosin për fushën, intensitetin dhe fokusin e partneritetit me NATO-n duke përfshirë qëllimet individuale. Këto lloje të partneritetit përcaktohen në një dokument, në të cilin parashtrihen qëllimet e bashkëpunimit, të cilat rishikohen në baza të rregullta. Rrjedhimisht, fushat e bashkëpunimit përfshijnë: (i) konsultimin, (ii) ndërveprimin, (iii) kontributin e partnerëve në operacionet dhe misionet e udhëhequra nga NATO-ja dhe (iv) reformën në fushën e mbrojtjes dhe ndërtimin e kapaciteteve përmes edukimit dhe trajnimeve.¹⁶

Ky raport zbërthen programet përkatëse të NATO-s, në të cilat institucionet e Kosovës dhe palët tjera vendore parashihen të marrin pjesë duke filluar nga viti 2017.

2.1. Programet për mbrojtje nga sulmet kibernetike, edukim, trajnim dhe logjistikë

Mbrojtja e sistemeve të komunikimit dhe informacionit ishte vënë në agjendën politike të NATO-s më 2002 në Samitin e Pragës dhe ishte përsëritur më

pas në Samitin e Rigës më 2006. Mbrojtja nga sulmet kibernetike ishte zhvilluar në masë të madhe në vitin 2014 kur NATO-ja miratoi politikën e vet të forcimit dhe planin e veprimit. Këto të fundit e kanë renditur këtë politikë si një prej detyrave kyçe të mbrojtjes kolektive të NATO-s duke konfirmuar që ligjet ndërkombëtare zbatohen në kibernetikë dhe ka intensifikuar bashkëpunimin e NATO-s me këtë industri. Kështu që, mbrojtja e sistemeve të komunikimit të NATO-s është në mesin e prioriteteve kryesore të Aleancës.¹⁷ Kjo paraqet vendimet e vendeve anëtare të NATO-s në fushën e mbrojtjes së sulmeve kibernetike, procedurat për mbështetje të vendeve anëtare dhe integrimin e mbrojtjes nga sulmet kibernetike në planifikimin e operacioneve, përfshirë planifikimin e emergjencave civile. Kjo politikë përcakton rrugët e aktiviteteve të informimit, edukimit, trajnimit dhe ushtrimit, por edhe inkurajon progresin e mëtejshëm në nismat e ndryshme të bashkëpunimit me vendet partnere dhe organizatat ndërkombëtare. Sa i përket bashkëpunimit me vendet partnere në mbrojtjen nga sulmet kibernetike, NATO-ja është e angazhuar me vendet partnere në ndarjen e vlerave dhe qasjet e përbashkëta. Çfarëdo lloj kërkesë për bashkëpunim me NATO-n bëhet sipas rasteve individuale mbi bazën e interesit reciprok.¹⁸

Programet e NATO-s për edukim dhe trajnim kanë nisur të zbatohen që prej vitit 1949 kur ishte themeluar NATO-ja. Meqë edukimi dhe trajnimi janë zhvilluar gjatë kohës së reformave dhe transformimeve të ndryshme, rrjedhimisht këta mekanizma janë bërë pjesë integrale e NATO-s. Që nga vitit 2002 kur ishte themeluar Komanda Aleate për Transformim (ACT), edukimi dhe trajnimi individual janë rreshtuar me trajnimet dhe ushtrimet kolektive. ACT-ja garanton që edukimi dhe trajnimi i duhur janë zhvilluar nga kërkesat dhe analizat pasuese të cilat i zhvillojnë siç duhet edukimin dhe trajnimin më të përshtatshëm për çdo disiplinë. Sa i përket bashkëpunimit me vendet partnere, NATO-ja e shfrytëzon edukimin për të mbështetur reformat institucionale, veçanërisht programet e

14 Shih listën e vendeve partnere të Këshillit për Partneritet Euro-Atlantik në: <<https://goo.gl/lhvxAI>>. Përditësimi i fundit më 11 nëntor 2015. Qasur më 9 dhjetor 2016. Gjithashtu, shih listën e vendeve nënshkruese të Dokumentit Kornizë të Partneritetit për Paqe në: <<https://goo.gl/fXCZW0>>. Përditësimi i fundit më 10 janar 2012. Qasur më 9 dhjetor 2016.

15 NATO, "Partners". Përditësimi i fundit më 11 nëntor 2015. Gjendet në: <<https://goo.gl/lhvxAI>>. Qasur më 9 dhjetor 2016.

16 Për më shumë informata lidhur me fushat e bashkëpunimit në mes të NATO-s dhe partnerëve të saj, shih: <<https://goo.gl/rQU5N1>>. Përditësimi i fundit më 7 tetor 2016. Qasur më 7 dhjetor 2016.

17 NATO, "Cyber defence". Përditësimi i fundit më 1 dhjetor 2016. Gjendet në: <<https://goo.gl/cKBh42>>. Qasur më 10 dhjetor 2016.

18 Ibid.

NATO-s për edukim dhe trajnim janë të fokusuar në rritjen e ndërveprimit ndërmjet NATO-s dhe forcave të vendeve partnere.¹⁹ Programet për edukim dhe trajnim janë instrumente për bashkëpunim në ndërtimin, zhvillimin dhe reformimin e institucioneve arsimore në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe ushtrisë. Vendet partnere të cilat bashkëpunojnë me NATO-n mund të marrin pjesë në një varg të aktiviteteve arsimore, përfshirë kurse, tryeza të rrumbullakëta, seminare dhe punëtori të NATO-s. Përveç kësaj, NATO-ja ndan ekspertizën në fushën e kapaciteteve të mbrojtjes me vendet partnere përmes Procesit të Planifikimit dhe Rishikimit të Pfp-së për trajnime, ushtrime dhe operacione shumëkombëshe. Nga ana tjetër, logjistika sipas definicionit të NATO-s është shkenca e planifikimit dhe kryerjes së lëvizjes dhe mirëmbajtjes së forcave. Ajo mbulon këto fusha, si planin dhe zhvillimin, përvetësimin, ruajtjen, transportin, shpërndarjen, mirëmbajtjen, evakuimin dhe shkatërrimin e materialeve dhe pajisjeve ushtarake; transportimin e personelit; përvetësimin, ndërtimin, mirëmbajtjen, operimin dhe rregullimin e shërbimeve; dhe mbështetjen për shërbimet mjekësore dhe të shëndetit.²⁰ Logjistika ka rëndësi të madhe për çdo operacion ushtarak dhe në mungesë të saj operacionet nuk mund të zbatohen, veçanërisht në rastet e operacioneve jashtë vendit. Në fillim të viteve të 1990-ta, NATO-ja i është përshtatur ndryshimit të ambientit të sigurisë si pasojë e zgjerimit dhe partneritetit përmes programit të Pfp-së dhe programeve tjera të bashkëpunimit me Evropën Qendrore dhe Lindore, por edhe në operacionet në mbështetje të paqes në Ballkanin Perëndimor. Prandaj, nga viti 2002 nuk ka asnjë kufizim gjeografik sa i përket operacioneve të NATO-s dhe vet logjistika e kësaj organizate ka ndryshuar duke marrë parasysh që nisma të ndryshme kanë nisur të zhvillojnë kapacitetet e kërkuara.²¹

Kosova pritet të marrë pjesë në këto programe të NATO-s, megjithëse nuk është e qartë se në cilat fusha

të këtyre programeve do të mund të përfshihet. Sa i përket mbrojtjes nga kibernetika, mund të thuhet se Kosova do të përfshihet në fushat që ndërlidhen me aktivitetet e Forcës së Sigurisë së Kosovës (apo Forcave të ardhshme të Armatosura të Kosovës) derisa një bashkëpunim i mundshëm pritet të ngritet ndërmjet Kosovës e NATO-s mbi bazën e vlerave të përbashkëta. Sa i përket programeve të edukimit dhe trajnimit, Kosova mund të ketë dobi nga NATO-ja në reformat institucionale duke e rritur ndërveprimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (apo Forcave të ardhshme të Armatosura të Kosovës) dhe pranisë së NATO-s në Kosovë. Me përjashtim të ndërtimit, zhvillimit dhe reformimit të institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes në fushën e edukimit, Kosova mund të bashkëpunojë me këtë organizatë ndërkombëtare në kurse, tryeza të rrumbullakëta, seminare dhe punëtori të ndryshme të NATO-s në kuadër të këtyre programeve.

2.2. Programi për Ndërtimin e Integritetit

Programi për Ndërtimin e Integritetit (BI) fillimisht ka qenë i themeluar në vitin 2007 nga Këshilli për Partneritet Euro-Atlantik (EAPC). Në Samitin e Çikagos në vitin 2012, Programi i BI-së është konfirmuar nën Disiplinës e Edukimit dhe Trajnimit të NATO-s në kuadër të Programit Global të Komandës Aleate për Transformim. Metodatat e integritetit të NATO-s janë diskutuar edhe më tej në vitin 2014 në Samitin e Uellsit kur Programi i BI-së është rikonfirmuar si pjesë integrale e Nismës së NATO-s për Mbrojtje dhe Siguri për Ngritje të Kapaciteteve²². Duke qenë se korrupsioni dhe qeverisja e dobët janë sfida të sigurisë të cilat e dobësojnë demokracinë, sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik, gjatë Samitit të Varshavës në vitin 2016, NATO-ja ka theksuar rëndësinë e përmirësimit të ndërtimit të integritetit, masat kundër korrupsionit dhe qeverisja e mirë të cilat duhet të zbatohen në vendet anëtare dhe partnere të NATO-s. Për më tepër, në samit u miratua edhe Programi i BI-së i NATO-s, i cili ka konstatuar se *"institucionet transparente dhe llogaridhënëse të mbrojtjes nën kontrollin demokratik janë thelbësore për stabi-*

19 NATO, "Education and training". Përditësimi i fundit më 25 maj 2016. Gjetet në: <<https://goo.gl/5fwQ6s>>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

20 NATO, "Logistics". Përditësimi i fundit më 6 qershor 2012. Gjetet në: <<https://goo.gl/DrtRSu>>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

21 Po aty.

22 NATO, "Building integrity". Përditësimi i fundit më 5 tetor 2016. Gjetet në: <<https://goo.gl/LymsOz>>. Qasur më 10 dhjetor 2016.

*litetin në zonën Euro-Atlantike dhe qenësore për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e sigurisë.*²³

Programi i BI-së është i dizajnuar për të zvogëluar rrezikun e korrupsionit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë me qëllim të forcimit të qeverisjes së mirë të institucioneve të mbrojtjes. Aktivitetet e këtij programi të cilat janë të hapura për vendet anëtare dhe partnere të NATO-s përfshijnë: (i) Pyetësin vetë-vlerësues të BI-së dhe Procesin e Rishikimit nga Ekspertët, (ii) programe të përshtatura, (iii) aktivitete edukuese dhe trajnuese dhe (iv) publikimet.²⁴ Duke qenë një program i integruar brenda Disiplinës së Edukimit dhe Trajnimit të NATO-s, struktura e BI-së përfshin Stafin Ndërkombëtar të NATO-s si Autoritet Kërkuës si dhe Qendrën për Integritet në Sektorin e Mbrojtjes (CIDS) e cila operon në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes së Norvegjisë. Ky program është zhvilluar dhe menaxhuar nga Stafi Ndërkombëtar i NATO-s në bashkëpunim me Autoritetet Ushtarake të NATO-s si dhe Stafin Ushtarak Ndërkombëtar, Komanda Aleate për Transformim, Komanda Aleate për Operacione, dhe nën-komandat të cilat takohen në baza të rregullta. Përveç kësaj, partnerët zbatues të Programit të BI-së janë NATO-ja, shtete jo-anëtare të NATO-s, shoqëria civile dhe organizatat e tjera ndërkombëtare që japin kontribut përmes ekspertëve këshillues, duke organizuar aktivitete, duke bërë hulumtime dhe duke ofruar analiza e trajnime në kuadër të sektorit të mbrojtjes.²⁵

Që nga viti 2016, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës ka përgatitur planin e integritetit, i cili është zhvilluar në kuadër të mbështetjes në nivel ndër-shtetëror në mes të Qeverisë së Norvegjisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës me qëllim që të forcohet korniza e integritetit në këtë institucion. Plani i integritetit ka identifikuar fushat me rrezik të lartë për korrupsion dhe sjellje jo-etike, si në vijim: (i)

përmirësimi i sistemit të prokurimit dhe menaxhimit të pasurive, (ii) parandalimi i konfliktit të interesit, (iii) menaxhimi i burimeve njerëzore dhe (iv) forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm.²⁶ Ky plan është në pajtim me parimet e Programit të BI-së së NATO-s për të zvogëluar rrezikun nga korrupsioni.²⁷ Pasi që pritet të marrë pjesë në aktivitetet e Programit të NATO-së për Ndërtimin e Integritetit, Kosova do të vazhdojë të ndërtoj kapacitetet institucionale dhe në veçanti politikat e integritetit brenda Forcës së Sigurisë të Kosovës (apo Forcat e ardhshme të Armatosura të Kosovës). Në këtë drejtim, zbatimi i politikave për integritet mund të mbikëqyret përmes mekanizmave të këtij programi të NATO-s. Për më tepër, masat për të zvogëluar rrezikun nga korrupsioni dhe forcimi i qeverisjes së mirë në Forcën e Sigurisë së Kosovës (apo Forcat e ardhshme të Armatosura të Kosovës) do të mund të përfshijë pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e NATO-s për Ndërtimin Integritetit në pyetësin vetë-vlerësues dhe procesin e rishikimit nga ekspertët, programet e përshtatura dhe në aktivitetet edukuese e trajnuese.

2.3. Programi Shkenca për Paqe dhe Siguri

Programi Shkenca për Paqe dhe Siguri i NATO-s (SPS) është themeluar në vitin 1958 dhe promovon praktika bashkëpunuese në fushën e sigurisë me qëllim që të adresohen sfidat në rritje të sigurisë. Ky program bashkon shkencëtarë, ekspertë dhe përfaqësues nga vendet anëtare të NATO-s si dhe shtetet partnere, të cilët bashkëpunojnë për të adresuar këto sfida.²⁸ Programi SPS-së siguron fonde, këshilla nga ekspertë dhe mbështetje për aktivitete të ndërlidhura me sigurinë përmes punëtorive, kurseve të trajnimit ose projekte shumëvjeçare hulumtuese dhe zhvillimore. Ky program promovon dimensionet politike të NATO-s

23 Para. 130, Warsaw Summit Communiqué, Press Release (2016) 100, 9 korrik 2016. Përditësimi i fundit më 3 gusht 2016. Gjetet në: <<https://goo.gl/OGUBPS>>. Qasur më 5 dhjetor 2016.

24 NATO, "Building integrity". Përditësimi i fundit më 5 tetor 2016. Gjetet në: <<https://goo.gl/LymsOz>>. Qasur më 10 dhjetor 2016.

25 Po aty.

26 Ministry for the Kosovo Security Forces, "Integrity Plan (2016-2018)", qershor 2016, fq. 11-22. Gjetet në: <<https://goo.gl/zcV5WH>>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

27 Po aty, f. 8.

28 NATO, "The Science for Peace and Security Programme". Përditësimi i fundit më 9 prill 2015. Gjetet në: <<https://goo.gl/cJ12Qk>>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

në lidhje me vlerat e përbashkëta dhe mbështetjen për shoqërinë civile. Programi i SPS-së i NATO-s është shndërruar në një nga partneritetet kyçe të Aleancës duke bashkuar audiencë qeveritare dhe civile.

Tre dimensionet kryesore të Programit të SPS-së janë shkenca, partneriteti dhe siguria. Ky program ka vënë theksin rritja e rreziqeve dhe sfidave jo-tradicionale, duke përfshirë këtu terrorizmin, mbrojtjen nga armët kimike, biologjike, radiologjike dhe përbërësve të tjerë nuklearë, kërcënimet kibernetike, siguria e energjisë dhe shqetësimet rreth sigurisë së ambientit, aspektet njerëzore dhe shoqërore të sigurisë, veçanërisht zbatimi i Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Një program i tillë bën të mundur lidhjen në mes të shoqërisë civile dhe NATO-s përmes aktiviteteve që adresojnë sfidat globale të sigurisë. Hulumtuesit, akademikët, ekspertët qeveritarë në kapacitetin e aktorëve civil kanë një rol të rëndësishëm në ofrimin e asistencës për NATO-n në identifikimin, kuptimin dhe reagimin ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve. Ndërkohë, NATO-ja synon të garantojë që financimi dhe mbështetja janë të disponueshme për aktivitetet bashkëpunuese që adresojnë objektivat e NATO-s për qëllimet e sigurisë kundrejt promovimit të bashkëpunimit dhe partneritetit.²⁹

Megjithatë, mbetet e paqartë nëse institucionet shtetërore të Kosovës dhe organizatat e shoqërisë civile do të përfshihen në këtë program për bashkëpunim me NATO-n. Prandaj, përgjigja e NATO-s për institucionet e Kosovës nuk ka treguar saktësisht se në cilat dimensione të këtij programi do të marrin pjesë këto të fundit, përveç që thuhet se NATO *“do të shqyrtojë rrugët alternative”* të përfshirjes së Kosovës në *“disa”* aktivitete të Shkencës për Paqe dhe Siguri.³⁰ Pavarësisht kësaj, Kosova mund të ofrojë ekspertizë dhe të ndajë praktikat e saj me NATO-n për të adresuar në mënyrë të përbashkët rreziqet e sigurisë dhe sfidat në lidhje me luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe me sigurinë njerëzore.

2.4. Qendra Koordinuese Euro-Atlantike për Reagim ndaj Fatkeqësive

E themeluar në vitin 1998 nga EAPC-ja, EADRCC-ja është planifikimi i emergjencave civile të NATO-s dhe paraqet një politikë të rëndësishme të EAPC-së për bashkëpunim ndërkombëtarë në fushën e zvogëlimit të fatkeqësive. Duke shërbyer si instrument i NATO-s për partneritet, EADRCC-ja udhëheq përpjekjet për menaxhimin e pasojave dhe operon si një mjet informacioni për ndarjen e ndihmës në fatkeqësi ndërmjet organizimit të seminareve për diskutim të mësimave të nxjerra nga operacionet dhe ushtrimet e NATO-s në raste të fatkeqësive natyrore.³¹ Për më tepër, ky organ kryen ushtrime vjetore të shkallës së lartë në terren me skenarë realiste për të përmirësuar ndërveprimin midis NATO-s dhe vendeve partnere. Veprimtaria e saj nënkupton ushtrime të mëdha në fatkeqësi në vende të ndryshme pjesëmarrëse për të praktikuar procedurat; të ofrojë trajnim për pjesëmarrësit vendorë dhe ndërkombëtarë; për të ngritur aftësitë dhe kapacitetet ndërvepruese; si dhe forcimin e përvijës dhe mësimet e nxjerra për operacionet e ardhshme. EADRCC-ja paraqet tek NATO-ja dhe vendet partnere kërkesat për ndihmë dhe e mban evidencën e ndihmës së ofruar; ndihmën e pranuar nga vendi i goditur; datat e ofrimit dhe ndihma që duhet të ofrohet edhe me tej si dhe situatën në terren. Kjo qendër është e vendosur në selinë e NATO-s në Bruksel, Belgjikë.³²

Kosova, më saktësisht Forca e Sigurisë së Kosovës (ose Forca e ardhshme të Armatosura të Kosovës), do të pritet të marr pjesë në cilësinë e vëzhguesit në Ushtrimet e Menaxhimit të Pasojave të EADRCC-së në përputhje me mandatin e vet.³³ Kosova ka përvijë të gjatë në planifikim të emergjencave që nga viti 1999 deri më tash (2017), përfshirë këtu aktivitetet e ish-Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe të Forcës së Sigurisë së Kosovës për të ndërmarrë operacione të mbrojtjes ci-

29 NATO Emerging Security Challenges Division, “The NATO Science for Peace and Security Programme”, Bruksel, dhjetor 2015, fq. 9-26. Gjetet në: <<https://goo.gl/QghFKE>>. Qasur më 11 dhjetor 2016

30 Letra e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, drejtuar kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, 5 dhjetor 2016, SG(2016)0357, f. 1.

31 NATO, “Euro-Atlantic Disaster Response Coordination Centre”. Përditësimi i fundit më 7 prill 2016. Gjetet në: <<https://goo.gl/6qbsTB>>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

32 Po aty.

33 Letra e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, drejtuar kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, 5 dhjetor 2016, SG(2016)0357, f. 2.

vile dhe në asistimin e autoriteteve civile ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera.³⁴ Në këtë rast, institucionet e Kosovës mund të ndajnë përvojën e tyre me vendet anëtare dhe partnere të NATO-s në planifikim të emergjencave për të kontribuar më tej në ushtrime të përbashkëta të EADRCC-së.

2.5. Diplomacia Publike

Në aspektin e komunikimit me publikun, NATO-ja bashkëpunon me mediat dhe programet e diplomacisë publike me palët e interesuara, përfshirë liderët e opinionit, grupet akademike dhe parlamentare, të rinjtë dhe qarqet edukative.³⁵ Përveç mediave tradicionale, NATO-ja përdor mediat e internetit dhe angazhimin publik për të ngritur vetëdijen dhe të mbështesë rolin, objektivat dhe misionet e NATO-s. Programet dhe politikat i janë përshtatur ndryshimeve të politikave dhe mjedisit politik si dhe risive teknike që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në punën e komunikimit. Për më tepër, shërbimet e komunikimit të ofruara nga NATO-ja janë reformuar dhe ristrukturuar në shumë raste për t'u përshtatur me nevojat e ndryshme të një mjedisi të informacionit i cili është gjithmonë në zhvillim si dhe me nevojat e mjedisit të sigurisë.³⁶

Divizioni për Diplomaci Publike i NATO-s (PDD) mbështet aktivitete të ndryshme, përfshirë konferencat, seminarat dhe fushatat informative. Programet e saj të bashkë-sponzuaruara përfshijnë konferenca, seminare, punëtori, multimediat dixhitale apo projekte online mbi paqen dhe çështjet e sigurisë përmes granteve. Organizatat jo-qeveritare, universitetet dhe institutet hulumtuese janë përfituesit kryesorë të granteve nga PDD-ja. Fushat e projekteve janë kryesisht të fokusuar në agjendën aktuale të NATO-s, siç janë mbrojtja kolektive, siguria bashkëpunuese dhe partneritetet e NATO-s, roli i NATO-s në menaxhimin

e krizave, politika e dyerve të hapura të NATO-s si dhe kapacitetet e NATO-s dhe Mbrojtja e Zgjuar.

Aktorët shtetërorë dhe jo-shtetërorë në Kosovë, përfshirë institucionet përkatëse të Kosovës, organizatat jo-qeveritare, universitetet, institutet hulumtuese, mediat dhe organizatat të tjera përkatëse të shoqërisë civile në çështje të komunikimit, sigurisë dhe paqes do të jenë janë drejtpërdrejtë të përfshira në këtë program. Palët që do të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga PDD-ja e NATO-s do të jenë bashkërisht të përfshira me NATO-n në konferenca, seminare, punëtori dhe aktivitete të tjera në fushën e diplomacisë publike.³⁷ Pos këtyre çështjeve, kur bëhet fjalë për kontekstin e Kosovës, është e nevojshme që të ketë vizita më të shpeshta dhe takime të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, organizatave të shoqërisë civile, universiteteve, instituteve hulumtuese dhe mediave me përfaqësues përkatës të NATO-s në selinë e NATO-s në Bruksel në kuadër të PDD-së së NATO-s. Kjo do të kontribuojë më që publiku në Kosovë të ngrit vetëdijen dhe të kuptuarit e vlerave, politikave dhe aktiviteteve të NATO-s përtej perspektivave të misionit të KFOR-it në Kosovë, në mënyrë që të rrisin nivelin e debatit për paqen, sigurinë dhe çështje të tjera që ndërlidhen me sigurinë dhe mbrojtjen.³⁸

34 NATO, "The Kosovo Security Force now self-sustainable". Përditësimi i fundit më 30 korrik 2013. Gjetet në: <<https://goo.gl/5zaW0A>>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

35 NATO, "Communications and public diplomacy". Përditësimi i fundit më 20 qershor 2016. Gjetet në: <<https://goo.gl/eIPZlo>>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

36 Po aty.

37 NATO, "NATO Public Diplomacy Division's Co-Sponsorship Grants". Përditësimi i fundit më 3 shkurt 2015. Gjetet në: <<https://goo.gl/G7p5hl>>. Qasur më 11 dhjetor 2016.

38 Po aty.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

327(4/9:496.51)
061.1(4/9:496.51):355

Avdiu, Plator

Shqyrtimi i përgjigjes së NATO-s : cili është partneriteti me Kosovën? / Plator
Avdiu. - Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2017. – 13 f. ; 30 cm.

ISBN-978-9951-679-55-8

www.qkss.org

ISBN 978-9951-679-55-8



9 789951 679558